



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 124, datë 07.12.2010

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
KUJDESTARËVE TË OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE AKSIONARE DHE
TË QEVERISË VENDORE”

Në bazë dhe për zbatim pikës 3, nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 11, paragrafi 2, nenit 12, paragrafi 2 dhe nenit 13, paragrafi 3, të Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për Obligacionet e Shoqërive Aksionare dhe të Qeverisë Vendore”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë së Kujdestarëve të Obligacioneve të Shoqërive Aksionare dhe të Qeverisë Vendore”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI